

# STATUTI I SHOQERISE "2F GROUP" SH.P.K.

---

## STATUTI I SHOQERISE TREGTARE "2F GROUP" SHPK

### Neni 1

#### Emri

Eshte krijuar nje shoqeri me pergjegjisi te kufizuar e quajtur:  
"2F GROUP" sh.p.k.

### Neni 2

#### Forma

Forma e shoqerise eshte ajo e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ("SH.P.K."), sipas nenit 68 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008.

Shoqeria "2F GROUP" sh.p.k. zoterohet nga ortaku Ardit Milloshi, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributit te nenshkruar.

### Neni 3

#### Data e themelimit

Shoqeria eshte themeluar me date 12.01.2021.

### Neni 4

#### Ortaket

Ortaku i vetem i shoqerise eshte:

- 1- Ardit Milloshi, i biri i Adriatikut dhe i Suzanes, i datelindjes 03.05.1976, banues ne lagjen "Aqif Pasha" - Bashkia Elbasan, me nr.personal H60503074J, i paisur me karte identiteti me nr.030866672 leshuar ne date 28.03.2011.

### Neni 5

#### Selia

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Elbasanit ne Shqiperi.

Adresa e sakte e selise eshte: lagja "Aqif Pasha" rruga E Re, nr 495 Shkalla 3 Elbasan, Shqiperi.

# STATUTI I SHOQERISE "2F GROUP" SH.P.K.

---

## Neni 5/1

### Zyra Qendrore

Zyra qendrore e shoqerise tregtare eshte e njejte me adresën e selise.

Ne zbatim te nenit 8 pika 2 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", shoqeria tregtare i nenshtrohet dispozitave te ketij ligji.

## Neni 6

### Objekti i veprimtarise se shoqerise

1. Eksport – import i te gjitha produkteve industriale dhe ushqimore; tregtimi me shumice dhe pakice i çantave dhe aksesoreve; kryerja e zbatimit te punimeve te ndertimit civile dhe industriale; tregtimi i pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme; tregtimi i materialeve te ndertimit; tregtimi i materialeve dhe paisjeve elektrike dhe elektroshtepiake; tregtimi i materialeve hidraulike dhe hidrosanitare; tregtimi i veglave te punes; shfrytezimi dhe perpunimi i materialeve inerte; shfrytezimi dhe perpunimi i mermereve dhe gureve dekorative; tregtimi i produkteve ushqimore te konfeksionuara dhe te fresketa; katering; perpunimi dhe tregtimi i lendes drusore; perpunimi dhe tregtimi i mobiljeve; tregtimi i pjeseve te kembimit; prodhimi dhe tregtimi i konfeksioneve; tregtimi i produkteve kancelarie; tregtimi i paisjeve te zyrave, printera, kompiutera, etj.; tregtimi i celulareve dhe aksesoreve; tregtimi i produkteve kimike dhe te pastrimit; tregtimi i paisjeve dhe reagenteve laboratorike dhe mjekesore; projektim; konsulence;
2. Gjithashtu shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimtarite tregtare dhe industriale, qe do te jene te nevojshme dhe te dobishme per permbushjen e objektit te shoqerise, mund te leshoje garanci reale ose personale edhe ne favor te te treteve, mund te zoteroje kuota edhe ne shoqeri tregtare te tjera, te hape llogari bankare, si dhe te ndermarre te gjitha marrëdhëniet e nevojshme me subjekte te tjerë fizike apo juridike, institucione shteterore, etj.

## Neni 7

### Kohezgjatja e shoqerise

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj dhe vepron si person juridik me personalitet te plote per te vepruar per nje kohe te pacaktuar.



# STATUTI I SHOQERISE "2F GROUP" SH.P.K.

## Neni 8

### Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre

1. Personi përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë është z. Ardit Milloshi, me këto të dhëna identifikimi: lindur më datë 03.05.1976 në rrethin Elbasan, banues dhe me adresë të saktë të deklaruar: lagja "Aqif Pasha", rruga "Kol Papparisto", pall.494/1, shkalla 2, ap.15", me shtetësi Shqiptare.

Për efekt të komunikimit elektronik të parashikuar në këtë statut, nga ana e administratorit deklarohet kjo adresë e saktë e postës elektronike: geom.arditmilloshi@hotmail.it

Kompetencat e përfaqësimit janë të plota duke i dhënë tanger përfaqësuesit të përfaqësojë shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet juridike dhe për të gjitha veprimet juridike ku një nga palët e këtyre marrëdhënieve juridike apo veprimeve juridike, shfaqet shoqëria "2F GROUP" SH.P.K.

Ardit Milloshi emërohet si administrator dhe përfaqësues i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, për një afat prej 5 vitesh kalendarike, me të drejtë ripërteritje.

2. Shoqëria do të ketë një administrator të vetëm të emëruar. Nuk lejohet emërimi i dy ose më shumë administratorëve.

## Neni 8/1

### Ndalime dhe kufizime

1. Duke qenë se z. Ardit Milloshi, gëzon njëkohësisht edhe cilësinë e administratorit dhe të ortakut të vetëm të shoqërisë, bazuar në nenin 7 të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", z. Ardit Milloshi, si person fizik, i ndalohej të lidhë kontrata huaje apo garancie me shoqërinë.
2. Në lidhje me kontrata të tjera të mundshme, përveç atyre të përmendura në pikën 1 të këtij neni, parashikohet detyrimi që këto kontrata të lidhura me administratorin dhe shoqërinë "2F GROUP" SH.P.K., të regjistrohen në një procesverbal i cili bëhet në zyrën qendrore të shoqërisë.

## Neni 9

### Specimenti i nënshkrimit (firmes) së personit që përfaqëson shoqërinë përpara të tremeve

Ardit Milloshi  
(nënshkrimi)



## STATUTI I SHOQERISE "2F GROUP" SH.P.K.

---

### Neni 10

#### Vlera e kapitalit themeltar te nenshkuar

Kapitali themeltar i nenshkuar i shoqerise ka nje vlere prej 10000 (dhjetemije) leke.

### Neni 11

#### Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkuar

Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkuar eshte 1 (nje).

### Neni 12

#### Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkuar

Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkuar eshte 10000 (dhjetemije) leke.

### Neni 13

#### Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkuar

Pjesmarrja ne kapitalin themeltar te nenshkuar eshte:

-Ortaku Ardit Milloshi: 100%;

### Neni 14

#### Vlera dhe lloji i kontributit te ortakeve

Vlera e kontributit te ortakut Ardit Milloshi eshte 10000 (dhjetemije) leke.  
Lloji i kontributit te ortakut Ardit Milloshi eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

### Neni 15

Kapitali fillestar i nenshkuar eshte paguar nga ortaku ne menyre te rregullt, plotesisht dhe rregullisht. Emri tregtar i shoqerise do te jete DUKI DASO ALBANIA

### Neni 16

#### Ndalimi i konkurrences

Ndalimi i permendur ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", mund te shfuqizohet nepermjet nje autorizimi te posaçem, te dhene nga ortaku i vetëm sipas dispozitave te nenit 36 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

## STATUTI I SHOQERISE "2F GROUP" SH.P.K.

### Neni 16/1

Ne mungese te nje shfuqizimi te parashikuar nga neni 16 i ketij statuti, ndalimi i konkurrences i parashikuar ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", mbetet ne fuqi deri ne 1 (nje) vit kalendarik pas humbjes se cilesive te permendura ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901.

### Neni 17

#### Kalimi i kuotave

- a) Kalimi i kuotave midis te gjalleve:
- 1- Ne rast kalimi kuotash, kalimi duhet te behet detyrimisht me kontrate noteriale.
- b) Kalimi i kuotave ne rast vdekje:
- 1- Kalimi i kuotave ne rast vdekje behet lirisht ne favor te perfituesit legjitim.
  - 2- Ne rast kur kalimi i kuotave i takon 2 ose me shume personave, kuotat do te ndahen midis tyre.

### Neni 18

#### Shperndarja e fitimeve

Ortaku ka te drejte te ndaje pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise.

### Neni 19

#### Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme mund te mblidhet dhe jasht selise se shoqerise, por gjithsesi brenda territorit shqiptar. Asambleja e pergjithshme, eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- 1- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- 2- Ndryshimet e statutit;
- 3- Emerimin e shkarkimin e administratorit;
- 4- Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- 5- Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar;
- 6- Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

## STATUTI I SHOQERISE "2F GROUP" SH.P.K.

- 7- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- 8- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- 9- Pjestimin e kuotave dhe anullimi i tyre;
- 10- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit;
- 11- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- 12- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;
- 13- Nisjen e nje hetimi te posaçem per parregullsitet pergjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare, hetim ky i cili kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes;
- 14- Miraton bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve, dokumente keto te paraqitura nga administratori.
- 15- Vendos per likuidimin me nje procedure te pershpejtuar sipas nenit 25 te ketij statuti.
- 16- Çeshtje te tjera te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

### Neni 20

#### Marrja e vendimeve

Ne lidhje me vendimet per:

- 1- Ndryshimin e statutit.
- 2- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar.
- 3- Shperndarjen e fitimeve.
- 4- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

asambleja vendos me te pakten 3/4 e votave te ortakeve pjese-marres ne mbledhjen e asamblese.

Ne lidhje me vendimet e tjera, te renditura ne nenin 19 te ketij statuti, asambleja vendos me shumicen e thjeshte te votave te ortakeve pjese-marres.

Te gjitha vendimet e asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal, ne perputhje me kushtet dhe rregullat e percaktuara ne nenin 90 te ligjit nr.9901.

### Neni 20/1

#### Kuorumi

Per vendimet qe neni 20 i ketij statuti kerkon shumice te cilesuar prej 3/4 te votave, asambleja nuk mund te marre vendime te vlefshme nese ne mbledhje nuk jane prezent personalisht ortaket qe zoterojne te pakten me shume se gjysmen e kuotave me te drejte vote ne shoqeri.

## STATUTI I SHOQERISE "2F GROUP" SH.P.K.

---

Per vendimet qe neni 20 i ketij statuti kerkon shumice te thjeshte, asambleja nuk mund te marre vendime te vlefshme nese ne mbledhje nuk jane prezent personalisht ortaket qe zoterojne te pakten me shume se 30 % (tridhjete perqind) te kuotave me te drejte vote ne shoqeri.

### Neni 20/2

#### E drejta e votes

Çdo kuote jep te drejten e nje vote.

### Neni 21

#### Te drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet qe:

- 1- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- 2- Te perfaqesoje shoqerine tregtare;
- 3- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- 4- Te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- 5- Te krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- 6- Te kryeje regjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sipas ligjit "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
- 7- Te raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- 8- Nese jane emeruar dy ose me shume administratore, keta e administrojne bashkerisht shoqerine. Asambleja e Pergjithshme me vendim te veçante, mund te percaktoje qe te kete rradhe hierarkike ne administrim, nga administratore te caktuar duke specifikuar rrethanat e kesaj perparsie ndermjet administratoreve.
- 9- Ne rast likuidimi ne gjendjen e aftesise paguese, i njofton per regjistrim QKR-se te dhenat e likuiduesve te pare dhe tagrat e tyre.
- 10- Te hape llogari bankare prane institucioneve financiare, te kryeje prane ketyre institucioneve te gjitha operacionet per llogari te shoqerise, te marre hua nga keto institucione.

- 11- Administratorit i ndalohet te terheqe me teper se 1.000.000 (nje milion) leke, nga llogaria bankare e shoqerise per nje periudhe me te vogel se 2 muaj. Terheqjet qe administratori do te kryeje nga llogaria bankare e shoqerise detyrohet ti dokumentoje me shkrim ne lidhje me destinacionin e tyre dhe arsyet e kesaj terheqjeje. Shkresat perkatese te realizuara me kete qellim, administratori eshte i detyruar ti ruaje dhe ti dorezoje tek ortakët ne fund te çdo muaji duke i informuar ata ne lidhje me keto terheqje, sipas dispozitave te parashikuara ne lidhje me njoftimin ne nenin 19/2 te ketij statuti. Barren e proves qe ky informim eshte realizuar e ka administratori.
- 12- Ne lidhje me veprimet ne kasen fiskale te shoqerise administratori ka te drejta te pakufizuara. Veprime financiare jashte llogarise bankare te shoqerise dhe jashte kases fiskale te shoqerise, administratori i ka te ndaluara ti kryeje. Ne lidhje me shumat financiare te arketuara nga kasa fiskale e shoqerise administratori eshte i detyruar qe keto shuma ti kaloje ne llogarine bankare te shoqerise brenda 1 (nje) jave kalendarike nga data e arketimit te ketyre shumave monetare, ose t'i riinvestoje ne aktivitetin e shoqerise.

Neni 22

Shperblimi i administratorit

Shperblimi i administratorit percaktohet me vendim te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme.

Shperblimi i administratorit duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare te shoqerise.

Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare, asambleja e pergjithshme mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratorit ne masen e pershtatshme.

Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te administratorit ne strukturen e kostove te shoqerise publikohet se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 23

Emerimi i likuiduesit

Ne rast se asambleja e pergjithshme vendos per likuidimin e shoqerise ne gjendjen e aftesise paguese, ajo eshte e detyruar te caktojë likuiduesin, brenda 30 diteve pas prishjes.



## STATUTI I SHOQERISE "2F GROUP" SH.P.K.

Ne caktimin e likuiduesit duhet te kihet parasysh se ky caktim nuk duhet te paraqese arsye te mjaftueshme per te dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqerise mund te cenohet nga likuiduesi i caktuar.

Neni 23/1

### Te drejttat dhe detyrat e likuiduesit

Likuiduesi merr persiper te drejttat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Kufizime te caktuara per veprimtarine e likuiduesit, mund te vendosen nga ortaku i vetem ne aktin e emerimit te likuiduesit. Keto kufizime publikohen ne menyre elektronike sipas nenit 61 te ligjit nr. 9723 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe kane efekt edhe ndaj te treteve duke u quajtur te njohura publikisht ne perputhje me nenin 12 te ligjit nr. 9901.

Likuiduesi ka detyre te ftoje kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e shoqerise.

Detyrat kryesore te likuiduesve jane:

- 1- Mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise.
- 2- Mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera.
- 3- Shitja e pasurive te shoqerise.
- 4- Shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhen e preferimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
- 5- Kryerja e veprimeve te reja tregtare ne funksion te mbylljes se nje veprimi te paperfunduar.

Kur likuiduesit vejne re se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e pretendimeve te ngritura nga kreditorët, likuiduesi pezullon proceduren e likuidimit dhe i kerkon gjykates nisjen e procedurave te falimentimit.

Neni 24

### Shperndarja e aktiveve

Pas shlyerjes se detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi i shperndan ortakeve aktivet e mbetura.

Neni 25

### Likuidimi i thjeshtezuar

Me vendim te saj, asambleja e pergjithshme mund te vendose per likuidimin e pershpejtuar.

## STATUTI I SHOQERISE "2F GROUP" SH.P.K.

Me marrjen e ketij vendimi dhe regjistrimin e tij te rregullt ne regjistrin e vendimeve, sipas kriterëve te ketij statuti, asambleja e pergjithshme eshte e detyruar te deklaroje perpara gjykates perkatese se te gjitha detyrimet e shoqerise ndaj kreditoreve jane shlyer e jane rregulluar te gjitha marredheniet me punemarresit.

Administratori i shoqerise njofton per regjitrin prane QKR-se vendimin e mesiperem.

Administratori dhe ortaket, jane pergjegjes solidarisht, per demin e shkaktuar nga shkelja e detyrave te tyre gjate likuidimit te thjeshtezuar.

Neni 26

### Dispozita te fundit

Ky statut hyn ne fuqi me regjistrimin e tij prane Qendres Kombetare te Biznesit.

*Arlet Millos*